



Pranuar / Dorezuar Prilijeno / Prodato Received / Delivery	13.10.2022	viti god year	2
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK	6172/2022		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.748/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtar dhe Zyle Millaku Gojnovci - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.748/2022 me datë 31.08.2022 e parashtruar nga ankuesi me adresë vendbanimi:

kundër Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike *"Masë disiplinore"*, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

I.REFUZOHET si e pabazuar ankesa më numër A.nr.748/2020 e datës 31/08/2020 e parashtruar nga ankuesi

II.MBETET në fuqi Vendimi me numër protokoli 031 i datës 15.08.2022, i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, sipas kontratës së punës të datës 30.06.2018, në vendin e punës *"Zyrtar korrektuese"*, në Qendrën Paraburgimit në Prishtinë, Zëvendësuesi i Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë, me datë 15.07.2022, ka iniciuar procedure disiplinore në bazë të rekomandimeve të komisionit të brendshëm hetimor nën dyshimin se ankuesi ka bërë shkelje të rëndë disiplinore, sipas nenit 46, paragrafin 2 nën paragrafin 2.1, paragrafin 3 nën paragrafin 3.1, 3.3 dhe nenit 48 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik,

Komisioni Disiplinorë në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datë 15.08.2022 ka nxjerrë Vendim me numër protokoli 031, me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *"Ndalim i 20% nga paga për periudhë dy (2) mujore"*.

Ankuesi kundër Vendimit me numër protokollit 031 të datës 15.08.2022 të Komisionit Disiplinorë, ka parashtruar ankesë me datë 31.08.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, i cili pretendon se masa e rëndë disiplinore i është shqiptuar në kundërshtim me ligjin në fuqi dhe në raport me nëpunësit e tjerë përgjegjës të cilëve ju është shqiptuar masë më e vogël "20% ndalim nga paga për periudhën një (1) muaj", kurse ankuesit i është shqiptuar masë e rëndë disiplinore "20% ndalim nga paga për periudhën dy (2) mujore".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 12.09.2022 e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa me datë 26.09.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës nga 1/30 faqe.

Kolegji për marrjen e vendimit meritator administroj këto prova: Ankesë e datë 31.08.2022 me numër protokollit 5040/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Deklaratë 08.07.2022; Vendim me nr.protokollit 031- i datës 15.08.2022 ; Orari për shëtitje i Qendrës Paraburgimit Prishtinë-i datës 08.07.2022; Shkresë Dhoma e Kontrollit e datës 08.07.2022 Qendrës Paraburgimit Prishtine; Shkresë e datës 12.07.2022 për personat e intervistuar, bashkëngjitur 3(tri) fotografi ; Inicimi i Procedurës Disiplinore me nr.ref.07/2022 e datës 15.07.2022 e protokolluar me nr.1988; Inicimi i Procedurës Disiplinore me nr.ref.05/2022 e datës 15.07.2022 e protokolluar me nr.1989; Inicimi i Procedurës Disiplinore me nr.ref 07/2022 e datës 15.07.2022 e protokolluar me nr.1990; Detyrat dhe përgjegjësitë e oficerit në shëtitore me nr.protokollit 3406-i datës 08.10.2021; Detyrat dhe përgjegjësitë e oficerit në bllok me nr.protokollit 3412-i datës 08.10.2022; Raport i hetues i datës 08.07.2022 me nr .protokollit 1950-i datës 13.07.2022; Vendim me nr.protokollit 1928-i datës 08.07.2022; Deklaratë e datës 08.07.2022 nga G.S; Deklaratë e datës 08.07.2022 nga Oficeri Xh.K; Vëzhgimi i kamerave nga komisioni hetimor i datës 12.07.2022; Intervistimi i të dënuarit F.B nga komisioni hetimor i datës 12.07.2022 dy(2) faqe; Intervistimi i zyrtarit korrektues G.S i datës 12.07.2022; Raport inicues disiplinor i datës 08/07/2022; Intervistimi i zyrtarit korrektues N.Sh i datës 12.07.2022 dy(2) faqe; Intervistimi i zyrtarit korrektues XH.K i datës 12.07.2022 dy(2) faqe; Intervistimi i Mb. N.Ç i datës 12.07.2022 dy(2) faqe; Intervistimi i zyrtarit korrektues B.D i datës 12.07.2022 dy(2) faqe; Orari i oficerëve për ndërrimin e ditës i datës 08.07.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë me nr. protokollit 5335-i datës 12.09.2022; Përgjigje në ankesë me nr. protokollit 5683 i datës 26.09.2022; Shkresat e lëndës për ankesën me nr.protokollit 974 i datës 23.09.2022; Fletkthesë me nr. protokollit 5335-i datës 12.09.2022; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e N.T prej datës 30.06.2018; Vendim me nr.protokollit 1928- i datës 08.07.2022; Kontrollimi i rrethojës së shëtitores në pavijon; Procesverbal i intervistës me stafin N.T tri(3) faqe; Ftesë për intervistë e datës 26.07.2022; Lista e të burgosurve prej pese (5) faqe; Flete kthese e datës 17.08.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka analizuar provat e lëndës ka konstatuar se ankuesi ka statusin e nëpunësit civil bazuar në dispozitën ligjore të nenit 4 paragrafit 1 të Ligjit

OS
KONTROLI
DOKUMENTAR
18/09/2022
18/09/2022

Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcakton se: *“nëpunësit profesional të shërbimit korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë”*, ku marrëdhënia e punës rregullohet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të provave të lëndës ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, pasi ka shqyrtuar shkresën me numër protokolli 1989 të datës 15.07.2022, me të cilën është iniciuar procedure disiplinore ndaj ankuesit me rekomandim të Komisionit të Brendshëm Hetimor të datës 13.07.2022, me pretendimet se ankuesi supozohet se ka bërë shkelje të rënda serioze të detyrave të punës, dhe pasi ka shikuar regjistrimet e kamerave ka dëgjuar dëshmitë e dëshmitareve dhe provat e paraqitura, me datën 15.08.2022, ka nxjerr vendim numër protokolli 031 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *„ndalim i 20% e pagës për një periudhë dy (2) mujore”* me arsyetimin që nëpunësi ka kryer shkelje disiplinore nga neni 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.3 lidhur me nenin 28 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtaresve Publikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili ka kundërshtuar Vendimin numër protokolli 031 me të datës 15.08.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, trajtimit të pabarabarte të shërbyesve civile si dhe zbatim të gabuar të ligjit material, ka konstatuar se pretendimet e ankuesit janë të paqëndrueshme sepse në bazë të shkresave të lëndës, është konstatuar që Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, ka arritur që në mënyrë bindëse dhe me prova konkrete konkretisht me regjistrimet e kamerave, deklaratat e dëshmitarëve dhe ankuesit, raportit të komisionit hetues të provojnë fajësinë e ankuesit, respektivisht duke marrë parasysh veprimet dhe mosveprimet e ankuesit, pakujdesin dhe moskujdesin e ankuesit gjatë kryerjes së detyrës. Në bazë të provave të lëndës edhe Komisioni i Brendshëm Hetimor ka bërë hetimin e kësaj çështje dhe ka intervistuar dëshmitarët lidhur me këtë dhe ankuesin, i cili në intervistën gjegjësisht në deklaratën e tij të datës 12.07.2022, para komisionit hetues ka deklaruar se me datë 08.07.2022 ka qenë i caktuar në krahun A/3 në detyrën e Oficerit të shëtitores të të dënuarve, në terminin e shëtitjes nga ora 14:15 minuta deri në ora 15:15 minuta në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë po ashtu ai ka pranuar se pas përfundimit të shëtitjes *„nuk e ka bërë numërimin e të dënuarve me rastin e kthimit të tyre nga shëtitorja dhe nuk e ka vërejtur se një i dënuar mungon, ndërsa numrin e të burgosurve në formular vetëm e ka shënuar pa i numëruar me saktësi’...’*, andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se vetë ankuesi ka pranuar që ka bërë një veprim të tillë i cili është në kundërshtim me rregullat e brendshme të institucionit po ashtu komisioni i brendshëm hetimor i datës 13.07.2022 baze të gjeturave dhe konstatimeve ka rekomanduar që: *“... stafi i caktuar në vendin e punës të respektoj rregullat e brendshme të Institucionit sipas përshkrimit të vendit të punës, që të bëhet numërimin e të burgosurve çdo herë siç parashihet dhe që numërimi i të burgosurve të jetë i saktë”*, gjegjësisht ka rekomanduar që të iniciohet procedure disiplinore nën dyshimin se ankuesi ka bërë shkelje disiplinore, respektivisht me veprimet dhe mosveprimet, pakujdesin dhe moskujdesin e tij gjatë kryerjes së detyrës me datë 08.07.2022 ku në ora 14:40 minuta në shëtitoren e Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë, kur të dënuarit e krahut A/3 kanë dalë në shëtitje sipas rutinës ditore të burgut, i dënuari F.Sh.B. me nr.QPPR-000691/22 rreth orës 14:45 minuta ka tentuar të arratiset,

i cili i ka dëmtuar telat e rrethojës së shëtitores që të dal me perimetrin e dytë duke e provuar të gjejë ndonjë mundësi për tu arratisur, dhe në atë kohë është vërejtur nga stafi i kamerave se i dënuari po tenton te arratiset, dhe në ora 15:28 minuta, është bërë ndalimi dhe është futur në pavijon, ndërsa ankuesi nuk i ka numëruar të burgosurit dhe nuk e ka vërejtur se një i dënuar mungon.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit është në përputhje me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil"*, pasi që ankuesi me veprimet e tij ka vepruar në kundërshtim me nenin 46 paragrafin 3 nën paragrafin 3.1 dhe 3.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcakton se: *"Shkelje të rënda konsiderohen: mos përmbushje e detyrave të punës dhe 3.3 moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale"*.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, me datë 15.08.2022 ka nxjerrë Vendim me numër protokolli 031, me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *"Ndalim i 20% e pagës për një periudhë dy (2) muaj"* me arsyetimin se nëpunësi ka kryer shkelje disiplinore nga neni 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.3 lidhur me nenin 28 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zytareve Publikë, me arsyetimin se ankuesi ka qenë i caktuar me datë 08.07.2022 në krahun A/3 në detyrën Oficerit të shëtitores të të dënuarve, në terminin e shëtitjes nga ora 14:15 minuta deri në ora 15:15 minuta, në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, kur një i burgosur ka tentuar që të arratiset dhe ankuesi nuk e ka bërë numërimin e të dënuarve pas kthimit të dënuarve nga shëtitorja dhe nuk e ka vërejtura se një i dënuar mungon.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara nga organi i punësimit dhe ankuesi konkretisht *"Përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të punës për pozitën „Oficer/Zyrtar në Shëtitore"* me numër protokolli 3412 të datës 11.10.2021, ku janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj pozite, citoj:.... *të kontrolloj perimetrin e shëtitores para dhe pas shëtitjes; Të kryej numërimin e saktë të burgosurve të cilët hyjnë dhe dalin nga pavijoni dhe anasjelltas...., Mbikëqyrë të gjitha lëvizjet e të burgosurve në shëtitore....Nuk lejohet të burgosurit të qëndrojnë në afërsi të telit të rrethojës së perimetrit dhe pavijonit...., Parandalon të burgosurit në ngjitjen rreth rrethojës së telit...'* ka konstatuar se rastin konkret ankuesi me rastin e mos numërimit të të burgosurve kur kanë dale në shëtitje dhe kur janë kthyer në pavijon nuk ka përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë sipas përshkrimit të detyrave të punës për pozitën *"Oficer/Zyrtar në Shëtitore"* dhe rrjedhimisht ankuesi ka bërë shkelje të rënda serioze të detyrave të punës në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.3 ndërlidhur me nenin 28 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar edhe pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore *"Ndalim 20% nga paga për periudhën dy (2) muaj"*, e ka diskriminuar në raport me dy kolegët - nëpunësit e tjerë përgjegjës të cilëve ju është shqiptuar masë disiplinore më e ultë *"Ndalim 20% nga paga për periudhën një (1) muaj"*, dhe ka konstatuar se pretendimi është i pa bazuara, sepse në



bazë të provave të lëndës është vërtetuar se ankuesi me datë 08.07.2022 ka qenë i caktuar në detyrë „Zyrtar në Shëtitore“ dhe ka qenë përgjegjës kur ka ndodh rasti që i burgosuri ka tentuar që të arratiset gjatë shëtitores, kurse nëpunësit e tjerë kanë qenë të caktuar në të njëjtën datë dhe orë, njëri në krahun A3 dhe A4 dhe tjetri në B5 të pavijoneve tjera që në fakt nuk kanë qenë përgjegjës për pjesën e shëtitores, kur ai ka qenë i caktuar të kontrolloj perimetrin e shëtitores para dhe pas shëtitjes, në bazë të përshkrimit të detyrave të punës.

Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në të gjitha provat e lëndës dhe deklaratimet e lartcekura, ka konstatuar se ankuesi me veprimet e tij ka bërë shkelje të detyrave të punës të përcaktuar me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij në fushën e disiplinës, për më tepër zyrtari publik në rastin konkret ankuesi nuk i është përmbajtur detyrimit për respektimin e ligjit, m siç parashihet me nenin 25 paragrafit 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“1. Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike”*, po ashtu zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit siç parashihet me nenin 26 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa sipas nenit 28 të këtij ligji, *zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli 031 të datës 15.08.2022 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore „Ndalim i 20% e pagës për një periudhë dy (2) mujore“, me arsyetimin se nëpunësi ka kryer shkelje disiplinore nga neni 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.3 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe shkelje të detyrave të punës dhe detyrimit të përgjegjshmërisë lidhur me nenin 28 të këtij ligji, ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 50 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se *1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit” dhe 2. “Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer”, sepse janë shqyrtuar të gjitha provat dhe faktet duke vlerësuar edhe rrethanat renduese dhe lehtësuese, gjegjësisht si rrethanë lehtësuese nuk u vërtetua se mos numërimi i të burgosurve dhe mos raportimi në dhomën e kontrollit nuk ka qenë i qëllimshëm por lëshim procedural, dhe me këtë rast masa e shqiptuar nga Komisioni Disiplinor është në pajtim me nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se „*Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj”*, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.*

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.748/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit.
- Sekretarit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivot të KPMSHCK- së .